



Financuar nga
Bashkimi Evropian

EURALIUS
Consolidation of the
Justice System in Albania

Heqje dorë nga përgjegjësia:

Jeni të lutur të vini re se ky dokument përbën një konsolidim jozyrtar të destinuar vetëm për qëllime informimi. Teksti nuk jep asnjë të drejtë dhe nuk imponon asnjë detyrim të ndryshëm nga çfarë parashikohet në legjislacionin e miratuar dhe të botuar në Fletoren Zyrtare. EURALIUS nuk garanton saktësinë dhe nuk mban përgjegjësi për përdorimin që mund t'i bëhet informacionit të mëposhtëm.

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Vendim Nr.209 datë 11.10.2019¹

PËR MIRATIMIN E “METODOLOGJIA PËR VLERËSIMIN DHE PIKËZIMIN E KANDIDATËVE JOGJYQTARË PËR NË GJYKATËN E LARTË”

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 136 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe në nenet 3, 4 dhe 49 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

V E N D O S I:

Miratimin e “Metodologjia për vlerësimin dhe pikëzimin e kandidatëve jogjyqtarë për në Gjykatën e Lartë”, sipas tekstit bashkëlidhur.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

¹ Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 140, datë 17 tetor 2019, <https://qbz.gov.al/eli/fz/2019/140/25721125-df91-4c04-8080-c3f191dbfd1c>

**METODOLOGJIA PËR VLERËSIMIN DHE PIKËZIMIN E
KANDIDATËVE JOGJYQTARË PËR NË GJYKATËN E LARTË**

1. Vlerësimi, pikëzimi dhe renditja e kandidatëve për vendet vakante në Gjykatën e Lartë bëhet duke u bazuar në kriteret e parashikuara në nenin 136 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenet 3, 4 dhe 49 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
2. Në mbështetje të pikës 12, të nenit 49, të Ligjit nr. 96/2016, rregulla më të hollësishme për kriteret dhe procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jogjyqtarë në Gjykatën e Lartë janë përcaktuar në aktin nënligjor normativ, Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 102, datë 05.07.2019 “Mbi kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jogjyqtarë dhe procedurën e përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë”².
3. Në dispozitat e ligjeve të sipërcituara dhe në Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 102, datë 05.07.2019, kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe të renditjes së kandidatëve klasifikohen në tre kategori:
 - A. Meritat profesionale;
 - B. Meritat morale dhe etike;
 - C. Meritat organizative dhe menaxheriale.
4. Detajimi i mëtejshëm i kriterëve ligjore të vlerësimit bëhet në Shtojcën e vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 102, datë 05.07.2019. Aty përcaktohen më në detaje ndarja e kategorive të vlerësimit në kritere, lista e kriterëve që përbëjnë secilën kategori, treguesit vlerësues për pikëzimin, pikëzimi maksimal i secilës kategori dhe kriter, si edhe burimet dokumentare dhe disa të dhëna për metodologjinë në funksion të vlerësimit dhe të pikëzimit të kandidatëve.
5. Sipas pikës 7, Kreu IV, të Vendimit nr. 102, datë 05.07.2019, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur të miratojë edhe metodologjinë që përmban shpjegime mbi mënyrën se si Këshilli orientohet dhe arsyetohet, sipas cilësive dhe të dhënave konkrete të kandidatëve, në raport me secilin prej kriterëve dhe treguesve të treguar në Shtojcën e këtij Vendimi, për vlerësimin dhe pikëzimin e tyre.
6. Kjo metodologji për vlerësimin dhe pikëzimin e kandidatëve jogjyqtarë për në Gjykatën e Lartë shpjegon orientimet që mban parasysh Këshilli në vlerësimin dhe caktimin e pikëve sipas secilës prej kategorive të meritave të kandidatëve.

²Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 98, date 8 korrik 2019, <https://qbz.gov.al/eli/fz/2019/98/77d76af6-e366-494c-b200-5da9bf3b90e8>

1. MERITAT PROFESIONALE (75 pikë)

A. Historiku arsimor dhe e shkuara profesionale (20 pikë)

Historiku arsimor (2 pikë)

Sipas këtij kriteri vlerësimi, caktimi i pikëve nga Këshilli për secilin kandidat orientohet duke u bazuar në rezultatet e studimeve të larta për drejtësi, brenda apo jashtë vendit, sipas përcaktimeve të nenit 49, pika 6, shkronja “c”, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 124 të Ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të këtij ligji.

Kriteri i vlerësimit i rezultatit të arritur në studimet e larta për drejtësi i referohet mesatares së notave jo më pak se 8, ose të barasvlershme me të, nëse studimet janë përfunduar jashtë vendit. Për vlerësimin e kandidatëve caktohet 1 pikë, duke filluar nga mesatarja e notave 8.

Në caktimin e pikëve për secilin kandidat Këshilli orientohet sipas vlerësimeve si më poshtë:

- a) Nota mesatare 8 - 9 = 1 pikë
- b) Nota mesatare mbi 9 = 2 pikë

Vlerësimi i kandidatit që ka kryer studimet jashtë vendit, bëhet mbi bazën e dokumentacionit të lëshuar nga një institucion i huaj i arsimit të lartë, të njëzuar nga ministria përgjegjëse për arsimin.

Në rastin e kandidatëve që kanë përfunduar studimet për drejtësi të ciklit të dytë, mesatarja përlllogaritet si mesatare e rezultateve të të dy cikleve të studimit.

Rezultatet e programeve të formimit fillestar (2 pikë)

Programet e formimit fillestar, të tilla si Shkolla e Magjistraturës, Shkolla e Avokatisë, Shkolla e Administratës Publike, etj., kontribuojnë në rritjen e profesionalizmit. Me anë të këtij kriteri vlerësohet niveli i rezultateve të angazhimit të kandidatit në ndjekjen e veprimtarive të kualifikimit fillestar profesional që mundësojnë arritjen e një profesionalizmi më të lartë në shërbim të ushtrimit të funksioneve dhe detyrave profesionale.

Si burim vlerësimi shërbejnë jetëshkrimi, informacione dhe dokumente zyrtare lidhur me rezultatet, vlerësimin dhe ecurinë e kryerjes së studimeve në programet e formimit fillestar.

Duke marrë parasysh të dhënat dhe informacionet në dispozicion, Këshilli cakton 1 pikë për rezultatet e studimeve të vlerësuara një nivel më të ulët se niveli maksimal (“mirë” ose “shumë mirë”, sipas programit) dhe 2 pikë për rezultate të vlerësuara në nivelin maksimal (“shumë mirë” ose “shkëlqyeshëm”, sipas programit).

Rezultatet e përvojës në profesion (4 pikë)

Ky tregues vlerëson nivelin e rezultateve të arritura gjatë përvojës së kandidatit në profesionin e juristit. Si burim vlerësimi shërbejnë jetëshkrimi, informacione dhe dokumente zyrtare lidhur me rezultatet, vlerësimin dhe ecurinë gjatë përvojës në profesion.

Duke marrë parasysh të dhënat dhe informacionet në dispozicion, Këshilli cakton 2 pikë për rezultatet e arritura gjatë përvojës profesionale si jurist të vlerësuara një nivel më të ulët se niveli maksimal (“mirë” ose “shumë mirë”, sipas llojit të profilit) dhe 4 pikë për rezultatet e vlerësuara në nivelin maksimal (“shumë mirë” ose “shkëlqyeshëm”, sipas llojit të profilit).

Për kandidatët për të cilët nuk ka vlerësime nga sisteme zyrtare vlerësimi, do të merren për bazë opinionet vlerësuese të strukturave drejtuese të organizmave ku ata bëjnë pjesë (si për shembull departamenti ose dekanati, dhoma e avokatisë, dhoma e noterëve, dhoma e ndërmjetësuesve etj.).

Rezultatet e trajnimeve të tjera, kualifikimeve pasuniversitare dhe gradat/titujt shkencorë (8 pikë)

Për të pikëzuar këtë kriter, Këshilli vlerëson rezultatet e trajnimeve të tjera (deri në 2 pikë), kualifikimet pasuniversitare (deri në 3 pikë), si edhe gradat shkencore dhe titujt akademikë (deri në 4 pikë). Në çdo rast, totali i pikëve të caktuara nuk mund të jetë më i lartë se maksimumi i pikëve për këtë kriter (8 pikë).

Për të realizuar një vlerësim sa më objektiv të kandidatëve që kanë tituj akademikë, grada shkencore, apo që kanë kryer studime të tjera afatgjata, mastera ekzekutivë dhe trajnime të tjera, mbahen në konsideratë edhe kriteret e përcaktuara në ligjin për arsimin e lartë (Ligji nr. 80/2015).

Për “trajnimet e tjera” Këshilli cakton deri në 2 pikë. Vlerësohen veçanërisht:

- a) trajnimet afat-shkurtra/afatmesme me një kohëzgjatje deri 2 javë, në 10 vitet e fundit, të cilat janë të shoqëruara me një certifikatë ose përmbajnë një komponent vlerësimi. Duke mbajtur parasysh numrin, llojet, tematikat dhe kohëzgjatjet e përgjithshme të trajnimeve në fusha të caktuara, si dhe institucionet trajnuese, Këshilli cakton 0.5 pikë për rezultatet e arritura gjatë trajnimeve të kryera në Shqipëri dhe 1 pikë për trajnimet e kryera në vendet e BE/OECD;
- b) trajnimet afat-gjata me një kohëzgjatje minimale 2 javore, deri në një semestër akademik, në 10 vitet e fundit, të cilat janë të shoqëruara me një certifikatë ose përmbajnë një komponent vlerësimi. Duke mbajtur parasysh numrin, llojet, tematikat dhe kohëzgjatjet e përgjithshme të trajnimeve në fusha të caktuara, institucionet trajnuese, Këshilli cakton 1 pikë për rezultatet e arritura gjatë trajnimeve të kryera në Shqipëri dhe 2 pikë për trajnimet e kryera në vendet e BE/OECD.

Për “kualifikimet pasuniversitare” Këshilli cakton deri në 3 pikë. Veçanërisht vlerësohen rezultatet e masterit ekzekutiv me relevancë në drejtësi/ligj dhe/ose të çdo studimi tjetër specializues afatgjatë në fund të të cilit lëshohet “Diplomë specializimi” në fushën përkatëse të programit të studimit. Duke mbajtur parasysh numrin, llojet, tematikat e kualifikimeve pasuniversitare, Këshilli cakton deri në 2 pikë për studime, me rezultate të larta (1 pikë për mesatare 8-9; 2 pikë për mesatare 9.1-10) të kryera në Shqipëri, dhe deri në 3 pikë (1.5 pikë për mesatare 8-9; 3 pikë për mesatare 9.1-10) nëse studimet janë kryer në vendet e BE/OECD.

Për “gradat shkencore dhe titujt akademikë”, duke mbajtur parasysh numrin, llojet dhe tematikat e gradave shkencore dhe titujve akademikë, Këshilli cakton deri në 4 pikë. Veçanërisht vlerësohen:

- a) rezultatet e larta, 95-100 pikë, ose ekuivalente, gjatë studimeve të doktoraturës në
-

drejtësi. Këshilli cakton deri në 2 pikë nëse grada shkencore “Doktor” është kryer në Shqipëri, dhe deri në 3 pikë nëse grada shkencore është kryer në vendet e BE/OECD;

b) titulli akademik “Profesor i asociuar”. Duke marrë parasysh fushën dhe institucionet e punësimit, Këshilli cakton deri në 2 pikë nëse kandidati e ka fituar titullin akademik në Shqipëri, dhe deri në 3 pikë nëse kandidati e ka fituar atë në vendet e BE/OECD;

c) titulli akademik “Profesor ose Professor Emeritus”. Duke marrë parasysh fushën dhe institucionet e punësimit, Këshilli cakton deri në 3 pikë nëse kandidati e ka fituar titullin akademik në Shqipëri, dhe deri në 4 pikë nëse kandidati e ka fituar atë në vendet e BE/OECD.

Aftësitë gjuhësore (4 pikë)

Në vlerësimin dhe pikëzimin e shkallës së zotërimit të gjuhëve të huaja sipas këtij kriteri, Këshilli mban parasysh njohjen nga kandidatët të pesë gjuhëve të huaja (anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht dhe spanjisht), sipas nenit 49, pika 3 dhe pika 6, shkronja “ç”, të Ligjit nr. 96/2016. Në mënyrë të veçantë, Këshilli vlerëson dhe pikëzon me përparësi njohuritë në gjuhët angleze dhe franceze. Shkalla e zotërimit të aftësive gjuhësore të kandidatit vlerësohet deri në 1.5 pikë për secilën gjuhë.

Për vlerësimin e njohurive për gjuhët e huaja, në rastet kur e vlerëson të nevojshme, Këshilli cakton ekspertë të gjuhës së huaj, të cilët japin mendim për shkallën e zotërimit të aftësive gjuhësore të kandidatit.

Për vlerësimin konkret në pikë të secilit kandidat për shkallën e zotërimit të gjuhës së huaj, Këshilli bazohet:

a) Në testet ndërkombëtare dhe në metodat, kriteret dhe nivelin e njohjes së gjuhës së huaj që përdoren nga institucionet e arsimit të lartë sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 80/2015, veçanërisht nenet 76 dhe 78 të tij, si edhe në Udhëzimin e Ministrit të Arsimit nr. 52, datë 03.12.2015 “Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar, përfshirë edhe Kuadrin e Përbashkët Evropian të Referencave për Gjuhët;

b) Në mendimin me shkrim të dhënë nga ekspertët, të cilët, pas intervistës që zhvillohet me kandidatin për këtë qëllim, japin vlerësimin e tyre për nivelin e njohjes së gjuhës së huaj. Përveç intervistës, eksperti mund ta mbështesë mendimin e tij edhe në punimet me shkrim të kandidatit në gjuhën e huaj.

Përkundrejt mospërfitimit të pikëve përkatëse për këtë kriter vlerësimi, kandidati mund të zgjedhë, sipas vlerësimit të tij, që të mos i nënshtrohet vlerësimit të Këshillit për gjuhët e huaja ose intervistës.

Këshilli mban parasysh edhe zotërimin e gjuhëve të tjera të deklaruara për të cilat kandidati nuk testohet gjatë intervistës, me kushtin që të jenë të shoqëruara me dokumente vlerësuese të vlefshme për nivelin e njohurive të tyre. Për gjuhët e tjera të ndryshme nga anglishtja dhe frëngjishtja, kandidati deklaron paraprakisht gjuhët në të cilat preferon të vlerësohet. Në këtë rast, kandidatit i shtohet deri një 1 pikë,

ose 0.5 pikë për secilin nga dy nivelet më të larta.

Gjithashtu, në varësi të të dhënave të jetëshkrimit profesional të kandidatëve dhe të dokumentacionit të vlefshëm të paraqitur prej tij, Këshilli përcakton, rast pas rasti, kandidatët për të cilët nuk nevojitet një certifikatë e njohjes së gjuhës ose verifikimi në intervistë i nivelit të njohjes së gjuhëve të huaja. Të tilla raste përfshijnë, ndër të tjera, kryerjen e studimeve të larta në cikël të plotë në universitete të njohura jashtë shtetit.

B. Kualifikimi i përgjithshëm profesional (25 pikë)

Pas vlerësimit dhe pikëzimit të kandidatëve sipas historikut të arsimit dhe të shkuarës së tyre profesionale (Seksioni A "*Historiku arsimor dhe e shkuara profesionale*"), ky Seksion (B) synon të identifikojë ata kandidatë të cilët kanë performuar në mënyrë të dalluar në fushën përkatëse të ushtrimit të profesionit. Prandaj, Seksioni B synon të vlerësojë dhe pikëzojë kandidatët duke u mbështetur në arritjen e rezultateve më të larta dhe të dallueshme profesionale, të konsideruara në përgjithësi.

Në vlerësimin dhe pikëzimin e kandidatëve, Këshilli vlerëson cilësinë e aftësive profesionale.

Vlerësimi cilësor

Midis të gjitha punimeve dhe dokumenteve profesionale gjatë pesë viteve të fundit të karrierës, kandidati përzgjedh dhe i parashtron Këshillit, pesë ndër punimet më të dallueshme sipas tij, ku paraqiten aftësitë e tij intelektuale dhe profesionale në nivelin më të lartë.

Elemente shtesë mbi cilësinë e rezultateve profesionale mund të nxirren edhe nga dokumentet zyrtare për rezultatet e procesit të vlerësimit profesional të paraqitura nga kandidati ose të kërkuara nga ana e Këshillit prej autoriteteve përkatëse, si edhe dokumentet zyrtare që paraqesin cilësinë dhe arritjet gjatë eksperiencës në punë, nga institucione kombëtare dhe ndërkombëtare.

Pesë dokumentet profesionale vlerësohen nga Këshilli në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar, mbështetur në tregues të tillë si:

1. Origjinaliteti dhe/ose impakti

Këshilli, në këtë rast, vlerëson nivelin e njohurive të reja të nxjerra nga pesë dokumentet e paraqitura prej kandidatit - në vend të përmbledhjes të thjeshtë të njohurive tashmë të njohura - edhe pse kandidati mund të ketë nxjerrë argumente nga punë të tjera kërkimore për të mbështetur argumentet e tij.

Në rastin e magistratëve dhe të avokatëve, kjo vlerësohet me anë të aftësisë për të ndikuar në zhvillimin dhe krijimin e praktikës së re gjyqësore, në elaborimin e doktrinës juridike, ose në interpretimin e ri të ligjit atje ku ekzistojnë boshllëqe ligjore ose ku ligji është i paqartë. Në rastin e profesorëve dhe lektorëve të lëndëve juridike, origjinaliteti dhe ndikimi identifikohen në kontributin ndaj një këndvështrimi të ri të punëve kërkimore ekzistuese. Vlerësohet gjithashtu nëse punimet e kandidatit kanë nxjerrë përfundime të reja nga një seri të dhënash kërkimore të publikuara. Në rastin e nëpunësve të nivelit të lartë në

administratën publike, origjinaliteti dhe impakti interpretohen si aftësia për të ndikuar dhe kontribuar në vendime të reja politikash solide në përputhje me ligjin, parimet kushtetuese dhe standardet ndërkombëtare, të përshtatura me kontekstin lokal.

2. Aftësitë analitike dhe hulumtuese

Aftësitë analitike i referohen mundësisë për të mbledhur dhe për të analizuar informacione dhe për të identifikuar zgjidhje me anë të një zhvillimi logjik të koncepteve ligjore. Një element kyç për mendimin analitik është aftësia për të identifikuar marrëdhëniet shkak-pasojë si edhe për të shqyrtuar se si konceptet, institutet dhe dispozitat e reja lidhen me ato origjinale, ose se si ato zbatohen në rastin konkret.

Në rastin e magjistratëve dhe avokatëve, dhe deri diku, për sa i përket profesorëve dhe lektorëve të së drejtës, kjo vlerësohet me anë të aftësisë për të identifikuar një çështje ligjore, për ta vendosur atë brenda parimeve të përgjithshme doktrinale, për të identifikuar burimet relevante të ligjit dhe për të ofruar argument në lidhje me zbatimin e parimeve dhe parashikimeve ligjore për zgjidhjen e problemit. Këshilli vlerëson gjithashtu aftësinë e kandidatit për të identifikuar dhe interpretuar në mënyrë të harmonizuar burimet e ndryshme të së drejtës. Në mënyrë analoge, në rastin e nëpunësve të nivelit të lartë në administratën publike, aftësitë analitike interpretohen si aftësia për të parashikuar probleme duke identifikuar paraprakisht pasojat e vendimeve për politikën dhe për gjetjen e zgjidhjeve efikase.

Aftësitë kërkimore i referohen aftësisë për të kërkuar, lokalizuar, organizuar dhe përdorur informacionet të cilat janë relevante për një temë të caktuar. Në këtë aspekt, Këshilli vlerëson se si kandidati përdor dhe krahason, në 5 punimet e paraqitura, burime të ndryshme nga sistemi vendas ligjor dhe nga sisteme të tjera ligjore. Këshilli vlerëson gjithashtu se si kandidati identifikon praktikën gjyqësore vendase dhe atë ndërkombëtare si dhe të dhënat relevante, në mbështetje të një vendimi ose interpretimi të caktuar.

3. Saktësia, konciziteti, zhvillimi logjik, lexueshmëria, kuptueshmëria dhe gjithëpërfshirja

Nëpërmjet këtyre treguesve Këshilli vlerëson nëse 5 dokumentet e paraqitura, kandidati bën një përcaktim të qartë të problemit; identifikon problemin paraprakisht, zhvillon në mënyrë logjike konceptet juridike, përdor në mënyrë korrekte dhe konsistente termat teknikë. Këshilli vlerëson gjithashtu nëse kandidati përdor një gjuhë të thjeshtë dhe të drejtpërdrejtë, nëse rregullat gramatikore dhe të sintaksës përdoren në mënyrë të saktë, nëse gjuha, paragrafët dhe struktura e fjalisë përzgjidhen në mënyrë të kujdesshme për të shprehur kuptimin, nëse krerët janë formuluar në mënyrë efikase për të orientuar lexuesit dhe për të dhënë kuadrin e plotë të dokumentit.

4. Interpretimi i harmonizuar

Nëpërmjet këtij treguesi Këshilli vlerëson aftësinë e kandidatit për të identifikuar dhe interpretuar në mënyrë të harmonizuar burimet e ndryshme të së drejtës si edhe për të treguar dhe argumentuar ligjin e zbatueshëm për zgjidhjen e problemit.

5. Referencat e praktikës gjyqësore

Për të pikëzuar kualifikimin i përgjithshëm profesional të kandidatëve, Këshilli vlerëson edhe aftësinë e tyre për të referuar dhe trajtuar me efektivitet, në vendin e duhur dhe sipas llojit dhe qëllimit të aktit, praktikën e konsoliduar gjyqësore, praktikën e unifikuar të Gjykatës së Lartë, praktikën gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, GJEDNJ-së, GJDBE-së dhe jurisprudencën në përgjithësi.

Duke pasur parasysh sa shpjegohet më sipër, Këshilli vlerëson pesë dokumentet sipas këtyre indikatorëve, duke caktuar pikë maksimale si më poshtë:

Indikator	Pikët Maksimale*
Originaliteti dhe impakti	5
Aftësitë analitike dhe hulumtuese	5
Saktësia, konciziteti, zhvillimi logjik, lexueshmëria, kuptueshmëria dhe gjithëpërfshirja	5
Interpretimi i harmonizuar	5
Referencat e praktikës gjyqësore	5
Totali	25

*Në rastin e plagjiaturës, nëse verifikohet nga bordi vlerësues i revistës apo institucion tjetër kompetent gjatë procedurës së vlerësimit, rezultatet e përgjithshme të këtij Seksioni, “Kualifikimi i përgjithshëm profesional” vlerësohen 0 pikë.

C. Kualifikimi shtesë profesional (30 pikë)

Në mënyrë ideale, Gjykata e Lartë përbëhet nga anëtarë me ekspertizë në fusha të ndryshme të së drejtës me një veprimtari të njohur profesionale. Fushat e ndryshme të ekspertizës plotësojnë njëra-tjetrën për të pasuruar dhe zgjeruar fushën e aktiviteteve të mbuluara nga Gjykata e Lartë.

Për këtë arsye, ky kriter i pikëzimit të meritave profesionale synon të vlerësojë rëndësinë dhe dobinë e specializimit të arritur në përvojën e veçantë profesionale të kandidatit, në mënyrë që të sigurojë “plotësimin e ekspertizës” profesionale dhe të pasurojë kapacitetet profesionale të Gjykatës së Lartë me profesionistë të spikatur nga (1) fusha e të drejtës civile, duke përfshirë edhe të drejtën tregtare dhe familjare, (2) e të drejtës penale dhe (3) e të drejtës administrative. Si e tillë, perspektiva e vlerësimit është e ndryshme nga vlerësimi i “kualifikimit të përgjithshëm profesional” në Seksionin B më lart.

Në varësi të profilin të tyre, kandidatët vlerësohen duke marrë një maksimum prej 30 pikësh. Në vlerësimin e kandidatëve, Këshilli merr parasysh llojin e ekspertizës, nivelin dhe kohëzgjatjen e angazhimit të posaçëm ose të profilizuar në fusha konkrete të së drejtës, dhe shtrirjen ndërkombëtare të angazhimit,

siç pasqyrohet në veprimtaritë profesionale të kandidatit dhe në ushtrimin e funksioneve institucionale, lidhur me ushtrimin e detyrave profesionale.

Juristët e spikatur vërehen nga eksperiencia e tyre e mëparshme e veçantë në Shqipëri, në institucionet ndërkombëtare apo në vendet e BE/OECD. Në varësi të të shkuarës profesionale dhe specializimit të kandidatëve Këshilli diferencon pikëzimin ndërmjet tyre, në bazë të: kohëzgjatjes së angazhimit në fushën specifike përkatëse; botimeve përkatëse dhe ndikimit të rezultateve profesionale në fushën e specializimit; konsulencave në fushën përkatëse të specializimit; dhe pjesëmarrjes në konferenca shkencore, mësimdhënies apo çmimeve dhe titujve të nderit të fituar.

Kohëzgjatja e angazhimit në fushën specifike (6 pikë):

Kohëzgjatja (Nr. i viteve)	Pikët
1-3	1
Mbi 3-6	2
Mbi 6-9	3
Mbi 9- 12	4
Mbi 12-15	5
Mbi 15	6

Duke marrë parasysh llojshmërinë e angazhimit në fushën specifike (për shembull si profesor, avokat, gjyqtar, këshilltar etj.) Këshilli mund të caktojë 1 pikë shtesë. Në çdo rast totali i pikëve të caktuara nuk është më i lartë se maksimumi i pikëve për këtë tregues (6 pikë).

Botime relevante dhe ndikimi i rezultateve profesionale në fushën specifike (6 pikë)

Këshilli cakton deri në 2 pikë për botime relevante në fushën specifike, të tilla si monografi, artikuj në revista shkencore, raporte, udhëzues, komentarë etj. Këshilli merr parasysh numrin e botimeve si edhe ndikimin e rezultateve profesionale në atë fushë, si për shembull përdorimin si pjesë e programeve të studimit, në praktikën e institucioneve, si referencë në punimet e autorëve të tjerë.

Këshilli cakton deri në 2 pikë shtesë nëse botimet relevante dhe ndikimi i rezultateve profesionale të kandidatit në fushën specifike janë realizuar në vendet e BE/OECD.

Gjithashtu, Këshilli cakton deri në 2 pikë shtesë për impaktin e botimeve relevante të kandidatit në zhvillimin e doktrinës dhe të jurisprudencës gjyqësore në këtë fushë.

Konsulenca dhe kontribute në hartimin e legjislacionit (6 pikë)

Për të vlerësuar këtë tregues Këshilli cakton deri në 4 pikë për konsulencat në fushën përkatëse të së drejtës si edhe për kontributet në hartimin e legjislacionit, bazuar në të dhëna të dokumentuara. Këshilli vlerëson rolin, sasinë dhe cilësinë e angazhimit, dhe ndikimin në veprimtarinë specifike.

Këshilli cakton deri në 2 pikë shtesë për shtrirjen ndërkombëtare të angazhimit duke vlerësuar nëse konsulenca në fushën përkatëse të ligjit është realizuar në vendet e BE/OECD.

Pjesëmarrja në konferenca shkencore, mësimdhënie, çmime dhe tituj (12 pikë)

Për të pikëzuar kandidatët, Këshilli vlerëson në veçanti edhe referimet në konferenca shkencore kombëtare, në fushën specifike të specializimit, bazuar në fjalimet e dorëzuara, dhe cakton deri në 2 pikë, duke marrë parasysh numrin e referimeve dhe rolin e referuesit.

Këshilli cakton deri në 2 pikë shtesë nëse referimet në fushën specifike - të dokumentuara nga fjalimet e dorëzuara nga kandidati - janë realizuar në konferenca shkencore ndërkombëtare në vendet e BE/OECD, duke marrë parasysh numrin e referimeve dhe rolin e referuesit.

Këshilli vlerëson edhe përvojën e mësimdhënies, në fushën specifike të specializimit, për profesionistët (për shembull gjyqtarët, prokurorët, avokatët etj.), dhe duke marrë parasysh numrin e angazhimeve, kohëzgjatjen, institucionin, rolin si mësimdhënës/trajtnues, cakton deri në 4 pikë.

Për përvojën si pedagog, me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme ose si "profesor vizitor/personel akademik i ftuar", në fushën specifike të specializimit, në vendet e BE/OECD, Këshilli cakton deri në 2 pikë.

Kandidatit i caktohen gjithashtu deri në 2 pikë për çmime ose tituj të veçantë nderi në vendet e BE/OECD.

2. MERITAT MORALE DHE ETIKE (15 pikë)

A. Integriteti moral dhe etik

Vlerësimi i meritave morale dhe etike mund të jetë problematik, sepse karakteristika të tilla janë jashtëzakonisht të vështira për t'u përkufizuar. Një kritikë e zakonshme është se vlerësimet e meritave morale priren të kenë norma të larta dështimi, janë subjektive dhe përdorimi i një vlerësimi shumë të rreptë mund të rezultojë në refuzimin e kandidatëve të ndershëm.

Parimet e Bangalorit parashtrojnë se nuk ka shkallë integriteti të përkufizuara si të tilla.³ Integriteti është një karakteristikë që gjyqtari e ka ose nuk e ka. Integriteti është absolut. Në gjyqësor, integriteti është më shumë se një virtut; është një domosdoshmëri.

Për të pikëzuar këtë kriter Këshilli vlerëson nëse kandidati miraton, respekton dhe mbështet vlerat themelore të punës së pritshme të gjyqtarit, siç janë (1) shmangja e shfaqjes së pahijshme, (2) nderi dhe dinjiteti, dhe (3) i përgjigjet pritshmërive të publikut, duke demonstruar cilësitë personale të mençurisë, ndershmërisë, ndjenjës së humanizmit, guximit, seriozitetit dhe maturisë. Kandidati duhet të jetë i vetëdijshëm se sjellja profesionale, jeta private dhe sjellja në shoqëri kanë ndikim në imazhin e drejtësisë dhe besimit të publikut.

³UNODC, Komentari për Parimet themelore të Bangalorit për Etikën Gjyqësore, Shtator 2007, https://www.unodc.org/documents/corruption/publications_unodc_commentary-e.pdf

Një nga sfidat e mëdha të Këshillit është gjetja e burimeve përkatëse dhe përcaktimi i besueshmërisë së tyre. Këshillit duhet të verifikojë informacionin në dispozicion. Për këto arsye, pikëzimi i këtij kriteri të vlerësimit bëhet sipas një rendi zbritës, duke supozuar se kandidati ka integritet etik dhe moral të plotë. Sipas kësaj qasjeje, kandidati e fillon procedurën e vlerësimit me totalin e pikëve referuar secilit tregues të këtij kriteri (5 pikë për secilin tregues), dhe nëse burime të provuara dhe të besueshme evidentojnë një mangësi të treguesve të integritetit moral dhe etik, Këshilli cakton vetëm 1 pikë. Në mënyrë që të shmanget që një person me aftësi të shkëlqyera njohëse, por me integritet moral dhe etik të ulët të renditet në vendet e para, skema e renditjes paraqet një gamë mjaft të lartë pikësh (1-15 pikë).

Në lidhje me këtë, puna e Këshillit udhëhiqet dhe mbështetet nga Parimet e Bangalorit për etikën gjyqësore dhe komentari përkatës⁴ si dhe parimet për etikën gjyqësore të përpunuara nga Rrjeti Evropian i Këshillave Gjyqësorë (ENCJ).⁵

Shmangia e shfaqjes së pahijshme (5 pikë)

Shmangia e shfaqjes së pahijshme është themelore për integritetin. Këshilli vlerëson nëse kandidati, në ushtrimin e detyrës dhe funksioneve, i shmanget çdo sjelljeje që tregon mungesë respekti, vetëpërmbajtjeje, ndjeshmërie, apo qasje të papërshtatshme dhe offensive - pra jo vetëm sjellje që formalisht kualifikohen se janë në kundërshtim me ligjin.

Gjithashtu, Këshilli merr parasysh në vlerësim nëse burimet e vlerësimit përmbajnë informacione mbi sjellje të tilla si:

- kandidati ka tejkalime dhe ekstravagancë në ushtrimin e profesionit të tij;
- kandidati ushtron dhe ka ushtruar (në të kaluarën) profesionin me njëanshmëri;
- kandidati kërkon nëpërmjet ndërhyrjes të përfitojë një avantazh të pamërituar për veten ose për të tjerët;
- kandidati pranon dhurata ose avantazhe për veten ose për të afërmit, kur ushtron detyrën ose profesionin.

Nderi dhe dinjiteti (5 pikë)

Në lidhje me nderin dhe dinjitetin, Këshilli vlerëson nëse kandidati transmeton vlera personale dhe profesionale dhe konsiderohet një model për të tjerët. Në vlerësimin e kandidatit dhe caktimin e pikëve, Këshilli merr parasysh nëse burimet e vlerësimit përmbajnë informacione mbi sjellje të tilla si:

- mungesë vëmendjeje dhe interesi për respektimin dhe dinjitetin e individëve;
- shpërdorimi i pronës publike;
- keqpërdorimi i kohës së punës, personelit dhe burimeve për qëllime private;

⁴ Id.

⁵Raporti për etikën gjyqësore I GRUPIT TË PUNËS SË ENCJ-së 2009-2010, <https://www.enci.eu/images/stories/pdf/ethics/judicialethicsdeontologiefinal.pdf>

- bullizëm (për shembull keqtrajtimi progresiv dhe sistematik i kolegëve ose stafit vartës, nëpërmjet abuzimit verbal, thashethemeve, përjashtimit social, ose përhapjes së thashethemeve);
- frekuentim i dobët (mungesa në punë);
- përdorimi i substancave të ndaluara.

Reputacioni (5 pikë)

Në përgjithësi, qëllimi i këtij treguesi është të vlerësojë nëse dhe deri në çfarë mase kandidati mund të pranohet se përmbush pritshmëritë e qytetarëve dhe të shoqërisë në lidhje me cilësitë profesionale të gjyqtarit, të tilla si: rezerva dhe diskrecioni, kujdesi dhe respekti, si dhe cilësitë personale si: mençuria, besnikëria, humanizmi, serioziteti dhe maturia.

Reputacioni, si i tillë, ndërtohet dhe vjen nga integriteti dhe profesionalizmi, të cilat gjithashtu vlerësohen edhe në kriteret e tjera të vlerësimit. Një reputacion i mirë nxit krijimin dhe rritjen e besimit, por reputacioni shkon edhe përtej performancës konkrete të individit, përderisa një pjesë thelbësore e reputacionit lidhet me perceptimin. Prandaj, për të shmangur mbivendosjet me vlerësimin e bërë në lidhje me tregues të tjerë, Këshilli merr parasysh këtu vetëm vlerësimin e aspekteve që nuk janë vlerësuar më parë.

Në caktimin e pikëve në dispozicion Këshilli vlerëson shkallën në të cilën mbizotëron perceptimi i mëposhtëm:

- sjellja e kandidatit krijon bindjen se vendimet e tij/të saj nxiten nga motive të ndryshme nga zbatimi i drejtë dhe i arsyetuar i ligjit;
- kandidati nuk kryen detyrat e tij profesionale në mënyrë të kujdesshme dhe efikase; ai nuk konsiderohet një person i devotshëm ndaj punës, me mentalitet praktik dhe nuk është model për të tjerët në angazhim;
- kandidati nuk kryen profesionin me ndershmëri, domethënë kandidati i tejkalon kompetencat që i janë besuar atij, si edhe kryen veprimtari që rezultojnë përtej kufijve ligjorë në raport me statusin ligjor dhe detyrat profesionale;
- kandidatit i mungon ndjenja e humanizmit;
- sjellja e përgjithshme e kandidatit nuk konsiderohet e përshtatshme në raport me detyrat profesionale dhe pritshmëritë e përgjithshme të një gjyqtari të Gjykatës së Lartë.

Këshilli përqendrohet në jetëshkrimin e kandidatit; në dokumente zyrtare që tregojnë arritje mbi nivelin e etikës dhe cilësive morale gjatë përvojave të punës; në informacione zyrtare të ardhura posaçërisht ose të bëra vetë publike nga institucione të tjera shtetërore; në informacione dhe opinione të ardhura nga institucionet publike që kanë lidhje me sistemin e drejtësisë, organizata të shoqërisë civile me veprimtari në mbrojtjen e të drejtave të njeriut ose të krijuara për mbrojtjen e interesave të përdoruesve të sistemit të drejtësisë; në informacione dhe dokumente të tjera të aksesueshme publikisht ose të paraqitura në

Këshill, si edhe në intervistën me kandidatin.

Rrethanat e evidentuara dhe të vlerësuara të paprovuara nga Këshilli gjatë fazës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, nuk mund të konsiderohen dhe të përdoren gjatë fazës së vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve. Të dhënat e dala nga burimet e vlerësimit analizohen në mënyrë objektive duke shmangur qëndrimin subjektiv të vlerësuesit apo anëtarit të Këshillit të krijuar mbi bazën e njohjeve personale me kandidatët.

3. MERITAT ORGANIZATIVE DHE MENAXHERIALE (10 pikë)

Gjyqtari duhet të ketë aftësi të mira organizative në mënyrë që të jetë produktiv. Kandidati për gjyqtar në Gjykatën e Lartë nuk mund të jetë efektiv pa pasur aftësinë për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar efektivisht punën. Produktiviteti, në çdo profesion dhe detyrë, është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon sa mirë kandidati përdor kohën e tij, si kur punon vetëm ashtu edhe në grup me të tjerë.

Për të pikëzuar këtë kriter, Këshilli do të mbështetet në të dhëna të dala nga burime të tilla si: jetëshkrimi i kandidatit; intervista me kandidatin; dokumente zyrtare që tregojnë arritje mbi nivelin e meritave organizative dhe meritave personale të tjera gjatë përvojave të punës; informacione zyrtare të ardhura posaçërisht ose të bëra vetë publike nga institucione shtetërore; informacione dhe opinione të ardhura nga institucionet publike që kanë lidhje me sistemin e drejtësisë, organizata të shoqërisë civile me veprimtari në mbrojtjen e të drejtave të njeriut ose të krijuara për mbrojtjen e interesave të përdoruesve të sistemit të drejtësisë, si edhe informacione dhe dokumente të tjera të aksesueshme publikisht ose të paraqitura në Këshill.

Cilësia e platformës dhe e vizionit të paraqitur (2 pikë)

Këshilli do të vlerësojë këtu cilësinë, vlerën dhe origjinalitetin e arsyetimit dhe objektivave të prezantuar nga kandidati në dokumentin ku paraqet programin dhe vizionin e tij mbi qasjen për të realizuar një organizim dhe funksionim cilësor dhe efikas të Gjykatës së Lartë, në ushtrimin e funksioneve të parashikuara në Kushtetutë dhe ligj.

Në lidhje me këtë tregues Këshilli do të vlerësojë sa vijon:

- a) nivelin e kuptimit që kandidati ka për rolin e tij si gjyqtar në Gjykatën e Lartë dhe për rolin e Gjykatës së Lartë si e tillë;
- b) vizionin e kandidatit në lidhje me sfidat kryesore me të cilat përballlet Gjykata e Lartë nga perspektiva organizative dhe e çështjeve thelbësore të së drejtës;
- c) mendimet dhe sugjerimet e kandidatit për t'i adresuar këto sfida.

Aftësitë vendimmarrëse (4 pikë)

Këshilli do të vlerësojë këtu nivelin e aftësive të fituara në përvojën, pozicionet dhe përgjegjësitë e mbuluara, në lidhje me aspektet që kanë të bëjnë me menaxhimin, planifikimin dhe administrimin e punës.

Këshilli mund të vendosë të caktojë pikë shtesë për kandidatët që kanë mbajtur pozicione drejtuese ose që kanë kryer funksione që përfshijnë vendimmarrje me efekt të drejtpërdrejtë ndaj palëve të treta.

Aftësitë e komunikimit (2 pikë)

Aftësia e komunikimit efektiv luan një rol të rëndësishëm në kryerjen e funksionit të një gjyqtari. Për të pikëzuar këtë kriter, Këshilli do të vlerësojë aftësinë për t'u shprehur në mënyrë të kuptueshme të qartë dhe koncize. Këshilli do të vlerësojë gjithashtu nëse kandidati është në gjendje të komunikojë me subjektet e tjera dhe të tretët në mënyrë jodiskriminuese, të matur, dhe me respekt.

Informacione të këtij lloji mund të merren sidomos nga intervistat, ashtu si dhe nga burimet dokumentare.

Puna në ekip dhe puna në ambiente multidisiplinore (2 pikë)

Kandidati i përshtatshëm për gjyqtar në Gjykatën e Lartë duhet të ketë kompetenca dhe aftësi për të punuar në kolegje me gjyqtarë të tjerë, për të shkëmbyer lirshëm dhe në mënyrë efektive pikëpamjet me kolegët dhe disponueshmërinë për të negociuar mospërputhjen e pikëpamjeve, nëse këto shfaqen.

Kandidati duhet të demonstrojë një qasje metodike ndaj punës, si dhe aftësinë për të qenë pjesë e një komuniteti pune, domethënë aftësinë për të punuar në ekipe me kolegët dhe anëtarët e stafit.

Për të pikëzuar këtë tregues, Këshilli do të vlerësojë eksperiencën e kandidatit gjatë karrierës, në punën në ekip dhe në ambiente multidisiplinore.